



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:166203

Datë: 15.10.2021

Numri i dokumentit: 02284581

P. nr 359/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. L. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë PP/II nr.1054/21 të datës . 26.07.2021 ,në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **13.10.2021**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj ,mbrojtësit të akuzuarit av. Ilir Rogova si dhe të akuzuarit M. L. ,me datën 15.10.2021 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **M. L.**, nga Gjakova , Rr” . . . , data e lindjes . . . , i biri i H. dhe i nënës D. e gjinisë K. ,ka te kryer shkollën fillore ,i gjendjes se dobët ekonomike ,i pa punë, i divorcuar atë i 1 fëmije , shqitparë ,shtetas i R. Kosovës,me nr. ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-me dt.14.07.2021 rreth orës 08:00 h, në Gjakovë, rr. “. . .”, pikërisht afër sheshit T.L., me dashje, me qëllim që vetit t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ia merr tjetrit pasurinë e luajtshme dhe atë të dëmtuarit A. U., në atë mënyrë që ditën, përmes dritares e cila ishte e hapur kishte depërtuar në veturën e të dëmtuarit “. . .” me targa . . . dhe nga aty merr pesë pasaporta të RKS-së (të dëmtuarit dhe familjarëve), trembëdhjetë palë pantolla, një qilim, këpucë dhe një kompresor (pompe) për fyerjen e gomave të makinës, me ç ’rast të dëmtuarit i shkakton dëm material në vlerë rreth 350 €.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit4,17, 38,43 46,47,48,49 par.5, 69, 70 dhe nenit 313 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **5 (pesë) muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro**, të cilat dënime nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

I dëmtuari A. U. nga Gjakova për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale të përcaktuara nga gjykata dhe ne emër te paushallit gjyqësorë shumë prej nga **30,00€**, në afat prej **15** ditësh, e gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II nr.1054/21 datës 26.07.2021 , e ka akuzuar të akuzuarin M. L. nga Gjakova , për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.13.10.2021, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë, prokurori Anton Hasanaj , lexoi aktakuzën PP/II nr.1054/21 dt. 26.07.2021., me ç ‘rast prokurori deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari M. L. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar ,lidhur me fajësinë dhe pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Ilir Rogova , thekson se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohet sipas aktakuzës duke i ditur edhe me pare pasojat dhe favorret juridike te pranimit te fajësisë, me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer për shkak të gjendjes në te cilën isha pasi që jam konsumues i alkoolit dhe këtë veprim e kam kryer në ndikim të alkoolit ,ku menjëherë të gjitha gjësendet qe i kam marr nga automjeti te dëmtuarit i janë kthyer te dëmtuarit nga St. Policor ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm , kërkojë falje nga i dëmtuari për veprimet e mija, pendimi i shprehur në gjykatës për veprën e kryer , gjendjen e dobët ekonomike , andaj i propozoi gjykatës që të marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se në te ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale te natyrës se njëjtë apo te ngjashme ,kërkim falje nga të dëmtuarit, gjendjen e dobët ekonomike , të më shqiptojë një dënim më të butë .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorret juridike te pranimit te fajësisë, ky pranim i fajësisë është bere edhe pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij si dhe sqarimit te mjaftueshëm nga ana e gjykatës për pasojat dhe favorret e pranimit te fajësisë , po ashtu ky pranim i fajësisë ka mbështetje edhe ne provat dhe materiale të cilat e mbështesin aktakuzën.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari M. L. : **-me dt.14.07.2021 rreth orës 08:00 h, në Gjakovë, rr. “. . .”, pikërisht afër sheshit T.L.,** me dashje, me qëllim që vetit t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ia merr tjetrit pasurinë e luajtshme dhe atë të dëmtuarit A. U., në atë mënyrë që ditën, përmes dritares e cila ishte e hapur kishte depërtuar në veturën e të dëmtuarit “. . .” me targa . . . dhe nga aty merr pesë pasaporta të RKS-së (të dëmtuarit dhe familjarëve), trembëdhjetë palë pantolla, një qilim, këpucë dhe një kompresor (pompe) për fyerjen e gomave të makinës, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton dëm material në vlerë rreth 350 €.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje në vazhdimësi nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere në pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari , pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat qe i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara

nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në diapozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana renduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marr parasysh personalitetin e tij, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës , sjelljen korrekte e të akuzuarit ne gjykim, premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm pasi qe veprimet e marra i ka bërë nen ndikim te alkoolit dhe tani me nuk konsumon alkool ,kërkim falja nga i dëmtuari , gjësendet e vjedhura i janë kthyer e dëmtarit , gjendjen e tij të dobët ekonomike Ne këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i tij që te gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm ,korrekt dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, te cilat rrethana ndikuan qe gjykata ti zbatoj dispozitat e zbutjes se dënimit te parapara ne nenin 70 të KPRK-ës, kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht renduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej 5(pesë) muaj ,si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 euro , të cilat dënime nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463par.2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë në shumë prej 30,00 € në emër të paushallit gjyqësor ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-s

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .
GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.359/21 më datë 15.10.2021

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatë së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:166203
Datë: 15.10.2021
Numri i dokumentit: 02284581